# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2023 – Numri: 154

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E hënë, 23 tetor 2023**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 18.10.2023 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023"........ | 16815 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 18.10.2023 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.348, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë e të huaj me armë të kategorive "B" e "C", në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar........ | 16826 |

**AKT NORMATIV**
**Nr. 5, datë 18.10.2023**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 84/2022, "PËR BUXHETIN E VITIT 2023"**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Nenet 1, 2, 3, 4 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"Neni 1

Buxheti për vitin 2023 është:

| | |
|---|---|
| Të ardhurat | 650 109 milionë lekë; |
| Shpenzimet | 705 607 milionë lekë; |
| Deficiti | 55 498 milionë lekë. |

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve.

Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2023 është:

| | |
|---|---|
| Të ardhurat | 477 967 milionë lekë; |
| Shpenzimet | 533 465 milionë lekë; |
| Deficiti | 55 498 milionë lekë. |

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2023 është:

| | |
|---|---|
| Të ardhurat nga të cilat: | 64 473 milionë lekë, |
| - transferta e pakushtëzuar e përgjithshme | 21 981 milionë lekë; |
| - transferta e pakushtëzuar sektoriale | 9 890 milionë lekë; |
| - të ardhura të tjera | 32 602 milionë lekë; |
| Shpenzimet | 64 473 milionë lekë. |

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2023 është:

1. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta.

| | |
|---|---|
| Të ardhurat gjithsej nga të cilat: | 159 912 milionë lekë, |
| - kontributet | 122 119 milionë lekë; |
| - transferimet nga buxheti i shtetit | 31 163 milionë lekë; |
| - transferta për indeksimin e pensioneve | 3 100 milionë lekë; |
| - bonusi i pensionistëve | 3 530 milionë lekë; |
| Shpenzimet | 159 912 milionë lekë. |

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë.

Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe për kategoritë e veçanta të personave të vetëpunësuar.

Për vitin 2023, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Sigurimi suplementar.

| | |
|---|---|
| Të ardhurat gjithsej nga të cilat: | 7 403 milionë lekë, |
| - kontributet | 2 480 milionë lekë; |
| - transferimet nga buxheti i shtetit | 4 823 milionë lekë; |
| - transferta për indeksimin e pensioneve | 100 milionë lekë; |
| Shpenzimet | 7 403 milionë lekë. |

Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 3 200 milionë lekë.

Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 3 450 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2023 është:

| | |
|---|---|
| Të ardhurat gjithsej | 54 536 milionë lekë, |
| nga të cilat: | |
| - kontributet dhe të tjera | 18 801milionë lekë; |
| - transferimet nga buxheti i shtetit | 35 735 milionë lekë; |
| Shpenzimet | 54 536 milionë lekë. |

Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk tejkalon tavanin prej 12 000 milionë lekësh.

Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 2

Në nenin 7, fjalët "... prej 5 000 milionë lekësh ..." zëvendësohen me "... 17 000 milionë lekësh ...".

Neni 3

Nenet 9 dhe 10 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore janë:

| | |
|---|---|
| Grantet | 30 558 milionë lekë; |
| Të ardhurat tatimore | 423 800 milionë lekë; |
| Të ardhurat jotatimore | 23 609 milionë lekë. |

Neni 10

Deficiti faktik i buxhetit të shtetit, i cili nuk duhet të rezultojë më tepër se deficiti i përcaktuar në nenin 1, të këtij ligji, mund të financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të brendshme deri në kufirin maksimal prej 25 000 milionë lekësh.

Pjesa tjetër e financimit të deficitit faktik të buxhetit të shtetit financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja, si dhe ndryshimit pakësues ose shtues të gjendjes së llogarisë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë dhe llogarive të fondeve speciale në bankat e nivelit të dytë.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja është rreth 52 310 milionë lekë, ku përfshihen huamarrjet dhe ripagesat me vlera të përafërta indikativë, si më poshtë vijon:

- Huamarrje afatgjatë e destinuar për projekte me vlerë rreth 20 800 milionë lekë;
- Emetimi i një Eurobondi, me vlerë prej rreth 68 958 milionë lekësh;
- Huamarrje në formën e "mbështetjes buxhetore" nga institucione financiare ndërkombëtare, me vlerë rreth 26 779 milionë lekë;
- Ripagesa të principalit, me vlerë rreth (minus) 65 026 milionë lekë, të cilat përfshijnë edhe një parablerje të mundshme, të pjesshme të Eurobondit ekzistues që maturohet në vitin 2025, për një vlerë orientuese prej rreth (minus) 22 986 milionë lekësh;
- Nënhua për pushtetin vendor, me vlerë rreth 800 milionë lekë.

Vlera indikative e akumulimit (shtesës) të gjendjes në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë është rreth (minus) 27 812 milionë lekë.

Vlera indikative e financimit, nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogaritë e fondeve speciale në bankat e nivelit të dytë është rreth 6 000 milionë lekë.

Çdo diferencë, që mund të rezultojë midis financimit total neto nga burimet e ndryshme të përmendura në këtë nen dhe deficitit faktik të buxhetit të shtetit, në rast teprice, akumulohet në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë ose, në rast mungese, përdoret nga gjendja e kësaj llogarie.

Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2023, përdoren jo më pak se 50 (pesëdhjetë) për qind për uljen e kufirit të huamarrjes neto nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila automatikisht rrit me të njëjtën masë kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit të përcaktuar në nenet 1 dhe 2, të këtij ligji.".

Neni 4

Në nenin 11 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- shpenzime të buxhetit qendror 511 365 milionë lekë;
- fondi rezervë i buxhetit dhe kontingjenca 17 200 milionë lekë;
- kontingjencë për risqet e borxhit 4 900 milionë lekë;”.

2. Paragrafi i shtatë shfuqizohet.
3. Në paragrafin e fundit, fjalët “... 100 milionë lekësh ...” zëvendësohen me “... 250 milionë lekësh ...”.
4. Në fund të nenit shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:
“Gjendja e mjeteve monetare, që do të rezultojë në fund të vitit buxhetor 2023 në llogarinë unike të thesarit, si rezultat i mosrealizimit të shpenzimeve ose tejkalimit të të ardhurave, transferohet në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë, në masën jo më shumë se 5 000 milionë lekë dhe përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave për shpronësime dhe vendime gjyqësore, që lidhen me shpronësimet.”.
5. Tabelat 1 dhe 4, që përmenden në këtë nen, bashkëlidhur ligjit, zëvendësohen me tabelat 1 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij akti normativ.

Neni 5

Tabela 2, e përmendur në nenin 12, bashkëlidhur ligjit, zëvendësohet me tabelën 2, që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 6

Në nenin 13, paga e Presidentit, nga 257 000 lekë në muaj bëhet 425 000 mijë lekë në muaj.

Neni 7

Neni 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 14

Fondi rezervë prej 3 800 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, si më poshtë vijon:
a) 2 000 milionë lekë, për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme;
b) 1 800 milionë lekë, për përballimin e kostos së zgjedhjeve.

Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4 900 milionë lekësh përdoret nga ministri përgjegjës për financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.
Kontingjenca prej 13 400 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për raste të paparashikuara.
Shumat e shpërndara nga fondi rezervë, kontingjenca dhe kontingjenca për risqet e borxhit shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11, të këtij ligji.”.

Neni 8

Tabela 3, që përmendet në nenin 15, bashkëlidhur ligjit, zëvendësohet me tabelën 3, që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 9

Nenet 19 e 20 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 19

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore dhe atij të garantuar të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese për vitin 2023, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 74 985 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:
- Për rritjen vjetore të borxhit të qeverisjes qendrore, deri në 80 726 milionë lekë;
- Për rritjen (pakësimin) vjetore të garancive të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, deri në (minus) 5 741 milionë lekë.
Stoku i borxhit publik vlerësohet të arrijë në 1 454 139 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:
- Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore 1 406 926 milionë lekë;
- Stoku i borxhit të garantur nga qeverisja qendrore 46 463 milionë lekë;
- Stoku i borxhit të qeverisjes vendore 750 milionë lekë.

Neni 20

Në rast se një parablerje e mundshme e Eurobondit ekzistues, që maturohet në vitin 2025, mund të jetë më e ulët sesa vlera orientuese prej 22 986 milionë lekësh dhe në rast të disbursimit të ndonjë kredie shtesë në formën e "mbështetjes buxhetore" nga institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe në rast të përdorimit të fondeve të përfituara nga alokimi i të drejtave të tërheqjes speciale prej Fondit Monetar Ndërkombëtar, kufijtë respektivë për huamarrjen totale neto, rritjen vjetore të borxhit të qeverisjes qendrore dhe nivelin e vlerësuar të stokut total të borxhit publik, të përcaktuar në këtë nen dhe në nenin 19, mund të tejkalohen deri sa shuma e vlerave të mëposhtme:

-Diferenca midis vlerës orientuese të parablerjes së mundshme të Eurobondit prej 22 986 milionë lekësh dhe vlerës faktike të parablerjes, përfshirë edhe vlerën faktike zero që do të rezultonte në rast të mosbërjes së parablerjes.

- Vlera e kredisë në formën e "mbështetjes buxhetore" të disbursuar.

- Vlera e përdorimit të fondeve të përfituara nga alokimi i të drejtave të tërheqjes speciale prej Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Ndërkohë, niveli i deficitit të buxhetit të vitit 2023 mbetet i pandryshuar, sipas përcaktimit në nenin 1, të këtij ligji.

Këshilli i Ministrave mund të akumulojë dhe mund të mbajë në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë çdo gjendje shtesë të likuiditetit që mund të krijohet dhe të mbartet për të financuar buxhetet e viteve fiskale pasardhëse, por, në mbyllje të vitit buxhetor, gjendja e akumuluar nuk duhet të kalojë vlerën mesatare prej dy muajsh kumulativë të shpenzimeve buxhetore të planifikuara për atë vit buxhetor.".

Neni 10

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## BUXHETI 2023
## SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Tab. 1

| Kodi | Emërtimi i institucionit/programit | Totali i shp. korrente | Shpenzimet Kapitale | | | Totali i shpenzimeve buxhetore |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Financim i brendshëm | Financimi i huaj | Totali i shp. kapitale | |
| **1** | **Presidenca** | **250,400** | **16,000** | **0** | **16,000** | **266,400** |
| 01120 | Veprimtaria e Presidentit | 250,400 | 16,000 | 0 | 16,000 | 266,400 |
| **2** | **Kuvendi** | **1,205,266** | **75,000** | **0** | **75,000** | **1,280,266** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 481,440 | 75,000 | 0 | 75,000 | 556,440 |
| 01120 | Veprimtaria ligjvënëse | 723,826 | 0 | 0 | 0 | 723,826 |
| **3** | **Kryeministria** | **526,500** | **50,000** | **0** | **50,000** | **576,500** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 526,500 | 50,000 | 0 | 50,000 | 576,500 |
| **5** | **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** | **9,127,100** | **2,939,272** | **3,565,260** | **6,504,532** | **15,631,632** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 401,700 | 7,000 | 0 | 7,000 | 408,700 |
| 04220 | Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit | 1,644,800 | 175,409 | 168,529 | 343,938 | 1,988,738 |
| 04240 | Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes | 904,600 | 1,374,000 | 0 | 1,374,000 | 2,278,600 |
| 04250 | Zhvillimi Rural duke mbësht. prodh. bujq, blek, agroind. dhe market. | 5,558,900 | 1,221,863 | 3,227,308 | 4,449,171 | 10,008,071 |
| 04860 | Këshillimi dhe informacioni bujqësor | 458,600 | 49,000 | 0 | 49,000 | 507,600 |
| 05470 | Menaxhimi qëndrueshëm i tokës bujqësore | 25,000 | 0 | 0 | 0 | 25,000 |
| 04230 | Mbështetje për peshkimin | 133,500 | 112,000 | 169,423 | 281,423 | 414,923 |
| **6** | **Ministria e infrastrukturës dhe energjisë** | **10,026,440** | **40,954,071** | **10,909,755** | **51,863,826** | **61,890,266** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 1,600,900 | 13,000 | 0 | 13,000 | 1,613,900 |
| 04520 | Transporti rrugor | 4,389,883 | 27,191,769 | 2,971,132 | 30,162,901 | 34,552,784 |
| 04540 | Transporti detar | 117,750 | 58,630 | 10,000 | 68,630 | 186,380 |
| 04550 | Transporti hekurudhor | 515,027 | 950,000 | 3,378,349 | 4,328,349 | 4,843,376 |
| 04560 | Transporti ajror | 2,020,300 | 12,700 | 0 | 12,700 | 2,033,000 |
| 04610 | Mbështetje për rrjetet e komunikacionit | 0 | 0 | 20,000 | 20,000 | 20,000 |
| 06370 | Furnizimi me ujë dhe kanalizime | 422,305 | 12,223,972 | 1,713,274 | 13,937,246 | 14,359,551 |
| 06220 | Menaxhimi i mbetjeve urbane | 200,000 | 0 | 97,000 | 97,000 | 297,000 |
| 04320 | Mbështetje për energjinë | 143,380 | 250,000 | 2,720,000 | 2,970,000 | 3,113,380 |
| 04430 | Mbështetje për burimet natyrore | 239,550 | 115,500 | 0 | 115,500 | 355,050 |
| 04440 | Mbështetje për industrinë | 303,585 | 104,500 | 0 | 104,500 | 408,085 |
| 06180 | Planifikimi urban | 73,760 | 34,000 | 0 | 34,000 | 107,760 |
| **10** | **Ministria e Financave dhe Ekonomisë** | **46,186,663** | **2,923,769** | **1,338,000** | **4,261,769** | **50,448,432** |

| Kodi | Emërtimi i institucionit/programit | Totali i shp. korrente | Shpenzimet Kapitale | | | Totali i shpenzimeve buxhetore |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Financim i brendshëm | Financimi i huaj | Totali i shp. kapitale | |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 745,000 | 342,000 | 550,000 | 892,000 | 1,637,000 |
| 01120 | Menaxhimi i shpenzimeve publike | 421,630 | 0 | 0 | 0 | 421,630 |
| 01130 | Ekzekutimi i pagesave të ndryshme | 947,830 | 895,000 | 0 | 895,000 | 1,842,830 |
| 01140 | Menaxhimi i të ardhurave tatimore | 2,683,597 | 395,080 | 0 | 395,080 | 3,078,677 |
| 01150 | Menaxhimi i të ardhurave doganore | 3,862,010 | 163,220 | 120,690 | 283,910 | 4,145,920 |
| 01160 | Lufta kundër transaksioneve financiare joligjore | 107,690 | 55,000 | 0 | 55,000 | 162,690 |
| 04130 | Mbështetje për zhvillim ekonomik | 296,500 | 62,000 | 100,000 | 162,000 | 458,500 |
| 04160 | Mbështetje për Mbikëq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr. | 356,000 | 22,000 | 0 | 22,000 | 378,000 |
| 10220 | Sigurimi shoqëror | 30,792,350 | 0 | 0 | 0 | 30,792,350 |
| 10550 | Tregu i punës | 2,303,006 | 131,000 | 0 | 131,000 | 2,434,006 |
| 04170 | Inspektimi në Punë | 187,670 | 5,000 | 0 | 5,000 | 192,670 |
| 09240 | Arsimi i Mesëm (profesional) | 2,293,380 | 403,469 | 567,310 | 970,779 | 3,264,159 |
| 06190 | Strehimi | 1,190,000 | 450,000 | 0 | 450,000 | 1,640,000 |
| **11** | **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë** | **44,055,000** | **3,274,000** | **383,000** | **3,657,000** | **47,712,000** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 740,879 | 48,000 | 0 | 48,000 | 788,879 |
| 09120 | Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin) | 24,618,434 | 1,307,000 | 0 | 1,307,000 | 25,925,434 |
| 09230 | Arsimi i mesëm (i përgjithshëm) | 6,868,687 | 1,062,000 | 0 | 1,062,000 | 7,930,687 |
| 09450 | Arsimi universitar | 10,700,000 | 610,000 | 178,000 | 788,000 | 11,488,000 |
| 09770 | Fonde për shkencën | 481,000 | 97,000 | 205,000 | 302,000 | 783,000 |
| 08140 | Zhvillimi i sportit dhe rinisë | 646,000 | 150,000 | 0 | 150,000 | 796,000 |
| **12** | **Ministria e Kulturës** | **2,653,481** | **1,376,000** | **100,000** | **1,476,000** | **4,129,481** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 294,408 | 0 | 0 | 0 | 294,408 |
| 08220 | Trashëgimia kulturore dhe muzetë | 706,135 | 53,500 | 50,000 | 103,500 | 809,635 |
| 08230 | Arti dhe kultura | 1,652,938 | 1,322,500 | 50,000 | 1,372,500 | 3,025,438 |
| **13** | **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** | **72,810,028** | **1,691,700** | **1,210,000** | **2,901,700** | **75,711,728** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 358,500 | 18,000 | 0 | 18,000 | 376,500 |
| 07220 | Shërbimit e kujdesit parësor | 6,141,933 | 291,318 | 138,000 | 429,318 | 6,571,251 |
| 07330 | Shërbimit e kujdesit dytësor | 31,753,667 | 1,214,204 | 1,032,000 | 2,246,204 | 33,999,871 |
| 07450 | Shërbimit e shëndetit publik | 3,857,428 | 90,400 | 0 | 90,400 | 3,947,828 |
| 10430 | Përkujdesja sociale | 29,562,000 | 77,778 | 40,000 | 117,778 | 29,679,778 |
| 01190 | Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë | 1,136,500 | 0 | 0 | 0 | 1,136,500 |
| **14** | **Ministria e Drejtësisë** | **11,904,551** | **943,000** | **110,000** | **1,053,000** | **12,957,551** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 539,770 | 601,800 | 110,000 | 711,800 | 1,251,570 |
| 03310 | Ndihma juridike | 62,950 | 2,000 | 0 | 2,000 | 64,950 |
| 01120 | Publikimet zyrtare | 51,500 | 5,000 | 0 | 5,000 | 56,500 |
| 01130 | Mjekësia ligjore | 91,072 | 101,000 | 0 | 101,000 | 192,072 |
| 03440 | Sistemi i burgjeve | 7,095,086 | 220,000 | 0 | 220,000 | 7,315,086 |
| 03350 | Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor | 146,300 | 5,000 | 0 | 5,000 | 151,300 |
| 01160 | Shërbimet për çështjet e birësimeve | 15,560 | 200 | 0 | 200 | 15,760 |
| 01180 | Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave | 3,737,517 | 6,000 | 0 | 6,000 | 3,743,517 |
| 03490 | Shërbimi i Provës | 164,796 | 2,000 | 0 | 2,000 | 166,796 |
| **15** | **Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme** | **2,922,049** | **52,999** | **0** | **52,999** | **2,975,048** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 282,773 | 37,999 | 0 | 37,999 | 320,772 |
| 01120 | Mbështetje diplomatike jashtë shtetit | 2,393,776 | 15,000 | 0 | 15,000 | 2,408,776 |
| 01130 | Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ-së | 245,500 | 0 | 0 | 0 | 245,500 |
| **16** | **Ministria e Brendshme** | **23,002,286** | **1,194,000** | **460,077** | **1,654,077** | **24,656,363** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 1,449,400 | 122,849 | 0 | 122,849 | 1,572,249 |
| 03140 | Policia e Shtetit | 18,551,300 | 926,151 | 460,077 | 1,386,228 | 19,937,528 |
| 03150 | Garda e Republikës | 2,000,300 | 10,000 | 0 | 10,000 | 2,010,300 |
| 01160 | Prefekturat dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor | 483,586 | 5,000 | 0 | 5,000 | 488,586 |
| 01170 | Shërbimi i Gjendjes Civile | 517,700 | 130,000 | 0 | 130,000 | 647,700 |
| **17** | **Ministria e Mbrojtjes** | **22,622,739** | **10,833,900** | **6,000,000** | **16,833,900** | **39,456,639** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 1,483,724 | 200,000 | 0 | 200,000 | 1,683,724 |
| 02120 | Forcat e luftimit | 6,179,200 | 7,749,800 | 4,100,000 | 11,849,800 | 18,029,000 |
| 09430 | Arsimi ushtarak | 759,420 | 267,000 | 0 | 267,000 | 1,026,420 |
| 02150 | Mbështetja e luftimit | 6,381,759 | 1,277,100 | 0 | 1,277,100 | 7,658,859 |
| 07340 | Mbështetje për Shëndetësinë | 1,327,836 | 180,700 | 0 | 180,700 | 1,508,536 |
| 10270 | Mbështetje sociale për ushtarakët | 5,200,000 | 0 | 0 | 0 | 5,200,000 |
| 10910 | Emergjencat civile | 1,290,800 | 1,159,300 | 1,900,000 | 3,059,300 | 4,350,100 |
| **18** | **Shërbimi Informativ Shtetëror** | **1,724,900** | **21,500** | **0** | **21,500** | **1,746,400** |
| 03520 | Veprimtaria informative shtetërore | 1,724,900 | 21,500 | 0 | 21,500 | 1,746,400 |
| **19** | **Drejtoria e Radio-Televizionit** | **618,000** | **0** | **0** | **0** | **618,000** |
| 08310 | Shërbimit për shqiptaret jashtë kufirit | 240,000 | 0 | 0 | 0 | 240,000 |
| 08520 | Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja | 220,000 | 0 | 0 | 0 | 220,000 |
| 08330 | Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare | 68,000 | 0 | 0 | 0 | 68,000 |
| 08340 | Orkestra simfonike e RTSH-së dhe e Kinematografisë | 90,000 | 0 | 0 | 0 | 90,000 |
| **20** | **Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave** | **212,700** | **70,000** | **0** | **70,000** | **282,700** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 212,700 | 70,000 | 0 | 70,000 | 282,700 |
| **22** | **Akademia e Shkencës** | **179,000** | **10,000** | **0** | **10,000** | **189,000** |

| Kodi | Emërtimi i institucionit/programit | Totali i shp. korrente | Shpenzimet Kapitale | | | Totali i shpenzimeve buxhetore |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Financim i brendshëm | Financimi i huaj | Totali i shp. kapitale | |
| 01520 | Veprimtaria akademike | 179,000 | 10,000 | 0 | 10,000 | 189,000 |
| **24** | **Kontrolli Lartë i Shtetit** | **486,100** | **20,000** | **3,000** | **23,000** | **509,100** |
| 01120 | Veprimtaria audituese e KLSH-së | 486,100 | 20,000 | 3,000 | 23,000 | 509,100 |
| **26** | **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** | **1,530,500** | **704,100** | **390,000** | **1,094,100** | **2,624,600** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 207,590 | 3,000 | 0 | 3,000 | 210,590 |
| 05320 | Programe për mbrojtjen e Mjedisit | 460,900 | 128,000 | 380,000 | 508,000 | 968,900 |
| 04260 | Administrimi i Pyjeve | 397,450 | 158,600 | 0 | 158,600 | 556,050 |
| 04760 | Zhvillimi i Turizmit | 464,560 | 414,500 | 10,000 | 424,500 | 889,060 |
| **28** | **Prokuroria e Pergjithshme** | **2,455,500** | **210,000** | **0** | **210,000** | **2,665,500** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 2,455,500 | 210,000 | 0 | 210,000 | 2,665,500 |
| **29** | **Këshilli I Lartë I Gjyqësor** | **3,631,600** | **731,000** | **0** | **731,000** | **4,362,600** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 309,700 | 15,000 | 0 | 15,000 | 324,700 |
| 01140 | Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë | 12,900 | 0 | 0 | 0 | 12,900 |
| 03310 | Buxheti Gjyqësor | 3,309,000 | 716,000 | 0 | 716,000 | 4,025,000 |
| **30** | **Gjykata Kushtetuese** | **168,500** | **8,000** | **0** | **8,000** | **176,500** |
| 03320 | Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese | 168,500 | 8,000 | 0 | 8,000 | 176,500 |
| **31** | **Agjencia Telegrafike Shqiptare** | **62,600** | **1,000** | **0** | **1,000** | **63,600** |
| 08320 | Veprimtaria telegrafike e ATSH-së | 62,600 | 1,000 | 0 | 1,000 | 63,600 |
| **35** | **Këshilli i Lartë i Prokurorisë** | **157,600** | **15,000** | **0** | **15,000** | **172,600** |
| 01110 | Veprimtaria e KLP-së | 157,600 | 15,000 | 0 | 15,000 | 172,600 |
| **40** | **Partitë politike** | **356,800** | **0** | **0** | **0** | **356,800** |
| 01110 | Mbështetje për Partitë Politike | 346,600 | 0 | 0 | 0 | 346,600 |
| 01120 | Mbështetje për shoqatat | 8,000 | 0 | 0 | 0 | 8,000 |
| 01130 | Mbështetje për organizatat e veteraneve me status | 2,200 | 0 | 0 | 0 | 2,200 |
| **41** | **Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** | **934,400** | **67,000** | **0** | **67,000** | **1,001,400** |
| 03390 | Veprimtaria e SPAK-ut | 934,400 | 67,000 | 0 | 67,000 | 1,001,400 |
| **50** | **Instituti Statistikës** | **1,135,400** | **355,600** | **200,000** | **555,600** | **1,691,000** |
| 01320 | Veprimtaria statistikore | 1,135,400 | 355,600 | 200,000 | 555,600 | 1,691,000 |
| **55** | **Shkolla e Magjistraturës** | **349,600** | **9,000** | **0** | **9,000** | **358,600** |
| 09820 | Veprimtaria arsimore | 349,600 | 9,000 | 0 | 9,000 | 358,600 |
| **56** | **Fondi i Zhvillimit Shqiptar** | **0** | **12,490,000** | **7,475,128** | **19,965,128** | **19,965,128** |
| 06210 | Programe zhvillimi | 0 | 7,490,000 | 7,475,128 | 14,965,128 | 14,965,128 |
| 06220 | Infrastruktura vendore dhe rajonale | 0 | 4,000,000 | 0 | 4,000,000 | 4,000,000 |
| 04230 | Programi "100 Fshatrat" | 0 | 1,000,000 | 0 | 1,000,000 | 1,000,000 |
| **57** | **Qendra Kombëtare e Kinematografisë** | **157,500** | **1,000** | **0** | **1,000** | **158,500** |
| 08220 | Mbështetja e veprimtarisë kinematografike | 157,500 | 1,000 | 0 | 1,000 | 158,500 |
| **63** | **Institucionet e sistemit të drejtësisë** | **782,800** | **78,500** | **0** | **78,500** | **861,300** |
| 03320 | Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtesisë | 215,400 | 73,000 | 0 | 73,000 | 288,400 |
| 03330 | Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magjistratit | 273,300 | 2,000 | 0 | 2,000 | 275,300 |
| 03340 | Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar | 205,400 | 2,000 | 0 | 2,000 | 207,400 |
| 03360 | Veprimtaria e Komisionerit Publik | 88,700 | 1,500 | 0 | 1,500 | 90,200 |
| **66** | **Avokati i Popullit** | **134,000** | **4,000** | **0** | **4,000** | **138,000** |
| 03320 | Shërbimi i avokatisë | 134,000 | 4,000 | 0 | 4,000 | 138,000 |
| **67** | **Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil** | **65,960** | **3,000** | **0** | **3,000** | **68,960** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 65,960 | 3,000 | 0 | 3,000 | 68,960 |
| **73** | **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** | **221,300** | **21,500** | **95,000** | **116,500** | **337,800** |
| 01610 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 221,300 | 21,500 | 95,000 | 116,500 | 337,800 |
| 01620 | Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **76** | **Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave** | **179,300** | **25,000** | **0** | **25,000** | **204,300** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 179,300 | 25,000 | 0 | 25,000 | 204,300 |
| **77** | **Autoriteti i Konkurrencës** | **78,540** | **5,000** | **0** | **5,000** | **83,540** |
| 04120 | Mbikëqyrja e tregut dhe garantimi i konkurrencës | 78,540 | 5,000 | 0 | 5,000 | 83,540 |
| **82** | **Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit** | **14,160** | **1,000** | **0** | **1,000** | **15,160** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 14,160 | 1,000 | 0 | 1,000 | 15,160 |
| **87** | **Institucione të tjera qeveritare** | **9,723,991** | **4,861,266** | **323,780** | **5,185,046** | **14,909,037** |
| 01320 | Shërbime qeveritare | 257,000 | 360,000 | 0 | 360,000 | 617,000 |
| 01130 | Shërbimi i Prokurimit Publik | 75,680 | 1,000 | 0 | 1,000 | 76,680 |
| 05640 | Administrimi i ujerave | 103,800 | 10,000 | 93,000 | 103,000 | 206,800 |
| 03310 | Shërbimi i Avokatisë Shtetërore | 221,400 | 2,000 | 0 | 2,000 | 223,400 |
| 01150 | Shërbime të tjera | 772,984 | 175,000 | 80,780 | 255,780 | 1,028,764 |
| 01140 | e-Qeverisja | 7,647,027 | 4,212,266 | 0 | 4,212,266 | 11,859,293 |
| 01330 | Menaxhimi dhe zhvillimi i administratës publike | 397,970 | 47,000 | 100,000 | 147,000 | 544,970 |
| 08610 | Mbështetje për rininë dhe fëmijët | 112,960 | 50,000 | 50,000 | 100,000 | 212,960 |
| 08480 | Mbështetje për kultet fetare | 135,170 | 4,000 | 0 | 4,000 | 139,170 |
